



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 18
31.10.2012

NR. VENDIMI 14
05.11.2012

V E N D I M
“PËR SEKUESTRIM PASURIE”

Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda e përbërë prej ;

Idriz MULKURTI – G J Y Q T A R

Asistuar nga sekretare Valbona Demiraj, ne Tirane sot me dt.05.11.2012, ora 14.30 mori në shqyrtim në séancë gjyqësore kërkesën penale Nr.18 Akti që i përket:

KËRKUES: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

ME OBJEKT: Sekuestrimin e pasurisë së shtetases (të dënuarës) D. M. si më poshtë:

- Dy llogari bankare në Raiffeisen bank ne shumat 1.100.000 Lek dhe tjetrën në shumën 3000 USD, në emër të D. M. .

- Shumat e parave: 358 USD, 245 Euro, 21700 Leke, 85.000 Leke, 2000 Euro, 4000 USD, sekuestruar shtetases D. M. në fazën e hetimeve paraprake të cilat janë në ruajtje në llogarine bankare të prokurorisë.

- Për ekzekutimin e këtij vendimi të ngarkohet zyrat e përmbarimit të rrethit Elbasan e Tiranë, ndërsa për administrimin dhe përdorimin e pasurive z.S. K. , i cili është administrator në Agjensine për Administrimin dhe përdorimin e pasurive të Sekuestruara dhe të konfiskuara pranë Ministrisë së Financave.

BAZA LIGJORE: Ligji Nr.10192 datë 03.12.2009 për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpëmjet masave parandaluese kundër pasurisë.

Gjykata në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të kërkesës, pasi shqyrtoi aktet e dëgjoi prokurorin i cili në përfundim kërkoi sipas objektit:

V Ë R E N :

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Renda Tiranë, me kërkesën e saj drejtuar gjykatës ka kërkuar, sekuestrimin e pasurisë së shtetasës (të dënuarës) D. M. e konkretisht; Dy llogari bankare në Raiffeisen bank në shumat 1.100.000 Leke dhe tjetrën në shumën 3.000 USD, në emër të D. M. si dhe shumat: 358 USD, 245 Euro, 21.700 Leke, 85.000 Leke, 2.000 Euro, 4.000 USD, sekuestruar shtetasës D. M. në fazën e hetimeve paraprake të cilat janë në ruajtje në llogarine bankare të prokurorisë duke bazuar kërkesën e saj në ligjin Nr.10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

Nga aktet e shqyrtuara gjatë seancës gjyqësore ka rezultuar si më poshtë:

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Renda Tiranë, në bazë të akteve të procedimit penal Nr.41 të vitit 2011 të Prokurorisë për Krime të Renda, ka regjistruar procedimin pasuror Nr.11 datë 31.10.2012 në ngarkim të shtetasës D. M. .

Prokuroria pasi ka përfunduar hetimet ka dërguar për gjykim procedimin penal Nr.41 të vitit 2011, në ngarkim të pandehurve G. H. , A. Gj. (G.) e D. M. , duke i akuzuar ata për veprën e parashikuar nga neni 283/a-2 e 22 i K.Penal.

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Renda Tiranë lidhur me shtetasen (të dënuarën) D. M. me vendimin e saj Nr.51 datë 26.07.2012 ka vendosur:

- Deklarimin fajtores të pandehurës D. M. M. për kryerjen e veprës penale të “Trafikimit të narkotikëve”, kryer në bashkëpunim, mbetur në tentative, parashikuar nga neni 283/a-2 e 22 i K.Penal dhe dënimin e saj me 10(dhjetë) vjet burgim.

- Në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale, përfundimisht e dënon të pandehurën D. M. M. me 6(gjashtë) vjet e 8(tetë) muaj burgim.

- Ti kthehen të pandehurës D. M. shuma 358 USD dhe 245 Euro, sekuestruar në momentin e arrestimit në flagrancë; shuma 21 700 leke,

sekuestruar në momentin e arrestimit në flagrancë depozituar në bankë; shuma prej 85 000 Leke, 2 000 EURO dhe 4 000 USD, sekuestruar gjatë kontrollit të banesës së kësaj shtetasje, depozituar në bankë.

Kundër vendimit Nr.51 datë 26.07.2012 të Gjykatës është ushtruar apel dhe Gjykata e Apelit për Krime të Rënda me vendimin e saj Nr.61 datë 22.10.2012 ka vendosur: Lënien në fuqi të vendimit Nr.51 datë 26.07.2012 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

Nga hetimi pasuror ka rezultuar se shtetasia D. M. është banore e qytetit të Elbasanit dhe se ka dy llogari bankare në Raiffeisen bank në shumat 1.100.00 Lek dhe tjetrën në shumën 3.000 USD, në emër të D. M. , këto të konfirmuara me shkresën Nr.12745/1 datë 05.12.2011 të Raiffeisen Bank sh.a. Po kështu gjatë veprimeve të kryera në hetimin paraprak për llogari të procedimit penal Nr.41 të vitit 2011, shtetases D. M. i janë sekuestruar shuma 358 USD, 245 Euro, e 21 700 Leke në momentin e arrestimit në flagrancë si dhe shumat prej 85 000 Leke, 2 000 Euro dhe 4 000 USD, gjatë kontrollit të banesës së saj. Këto shuma janë depozituar në bankë nga ana e prokurorisë.

Sipas shkresë Nr.22159/1 datë 29.12.2011 të Drejtorisë së Tatim Paguesve në përgjigje të kërkesës së Prokurorisë Nr.417 datë 22.11.2011 rezulton se shtetasia D. M. nuk është e regjistruar si person fizik apo juridik që të këtë aktivitet privat.

Një fakt të tillë prokurori e provoi në seancë me aktet si më poshtë:

Shkresë Nr.64. Akti datë 30.10.2012 e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

Urdhër për regjistrimin e procedimit pasuror Nr.11 datë 31.10.2012.

Kërkesë për gjykimin e procedimit penal Nr.41 të vitit 2012, datë 25.05.2012 e Prokurorisë për Krime të Rënda Tiranë.

Vendim Nr.51 datë 26.07.2012 i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë

Vendim Nr.61 datë 22.10.2012 i Gjykatës së Apeli për Krime të Rënda Tiranë.

Shkresë Nr.12745 Prot. datë 05.12.2011 e Raiffeisen Bank, bashkëngjitur shkresës janë nxjerrjet e llogarisë së shtetases D. M. që nga momenti i celjes gjithësej 18 (tetëmbdhjetë) fletë.

Procesverbal për kontrollin e banesës së shtetases D. M. datë 18.11.2011 ora 19.30, ku janë gjetur e më pas sekuestruar shumat prej 85 000 leke, 2 000 Euro dhe 4 000 USD.

Procesverbal për sekuestrimin e sendeve datë 18.11.2011 ora 23.00, ku janë sekuestruar prej 85 000 leke, 2 000 Euro dhe 4 000 USD.

Vendim për vleftësimin e kontrollit të banesës datë 20.11.2011.

Procesverbal mbi dorëzimin e provës materiale datë 22.11.2011.

Gjykata ne analizë të akteve të sipërcituara si dhe duke pasur parasysh kërkesat e neneve 3, 11, 14, 15 te ligjit Nr.10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpëmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, konkludon:

1. Të pranojë kërkesën e prokurorit për sekuestrimin e pasurive, për dy llogari bankare në Raiffeisen bank në shumat 1.100.000 Lek dhe tjetrën në shumën 3000 USD, në emër te D. M. për sa më poshtë:

Së pari: Shtetasia D. M. është dënuar për veprën penale parashikuar nga neni 283/a i K.Penal.

Se dyti: Ekziston rreziku për marrjen tërheqjen e kësaj pasurie nga banka e më pas tjetërsimin e saj.

2. Nisur nga fakti, se për pikën nr.2 të objektit të kërkesës kemi një vendim gjykate të formës së prerë, gjykata çmon se ndodhemi para gjesë së gjykuar, pasi për të njëjtën pasuri është shprehur një gjykate, pavaresisht se baza ligjore, sipas arsytimit te atij vendimi është neni 190 i K.Pr.Penale dhe jo ligji Nr.10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpëmjet masave parandaluese kundër pasurisë”. Në këto kushte gjykata çmon të rrëzoje kërkesën e prokurorit, për sekuestrimin e pasurive të shtetasës D. M. për shumat 358 USD, 245 Euro, 21700 Leke, 85000 Leke, 2000 Euro, 4000 USD, sekuestruar në fazën e hetimeve paraprake të cilat janë në ruajtje në llogarine bankare të prokurorisë, pasqyruar në pikën nr.2 të objektit të kërkesës, pasi ndodhemi para gjesë së gjykuar.

3. Lidhur me ekzekutimin e këtij vendimi gjykata çmon të ngarkojë zyrat e përmbarimit të rrethit Elbasan e Tiranë, meqënëse pasuria është depozituar në degën e Raiffeisen bank Elbasan e zyrat qendrore të Raiffeisen bank ndodhen në Tiranë, ndërsa për administrimin dhe përdorimin e pasurive z.S. K. , i cili është administrator në Agjensinë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave.

Sa sipër gjen mbështetje në shpjegimet e prokurorit, në aktet e paraqitura nga ana e tij në seancë të cilat ju nënshtruan shqyrtimit gjyqësor si dhe në ligjin Nr.10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpëmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

PËR KËTO ARSYE :

Gjykata bazuar në nenet 3, 11, 12, 14, 15 te ligjit Nr.10192 datë 03.12.2009 *“Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”*,

V E N D O S I:

-Pranimin pjesërisht të kërkesës:

-Sekuestrimin e pasurisë së shtetases (të dënuarës) D. M. për dy llogari bankare që ka në Raiffeisen bank, në shumat 1.100.000 (njemilionenjqindmije) leke dhe 3000 (tremije) USD.

-Rrëzimin e kërkesës për sekuestrimin e pasurisë së shtetases (të dënuarës) D. M. për shumat e parave, 358 USD, 245 Euro, 21700 Leke, 85000 Leke, 2000 Euro, 4000USD, sekuestruar në fazën e hetimeve paraprake të cilat janë në ruajtje në llogarinë bankare të prokurorisë, duke qënë se ndodhemi para gjesë së gjykuar, pasi për këto pasuri është shprehur gjykata me vendim themeli të formes së prerë Nr.51 datë 26.07.2012.

-Për ekzekutimin e këtij vendimi ngarkohen zyrat e përmbarimit të rretheve Elbasan e Tiranë, ndërsa për administrimin dhe përdorimin e pasurive z.S. K. , i cili është administrator në Agjensinë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave.

-Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda afatit ligjor në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda Tiranë.

Tiranë, me datë 05.11.2012

S E K R E T A R E

G J Y Q T A R

Valbona DEMIRAJ

Idriz MULKURTI

